

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA –SUHAREKË OPSTINA SUVA REKA MUNICIPALITY OF SUHAREKA	
---	--	---

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDËSHËM NË KOMUNËN E SUHAREKËS

Forma e raportit

Raporti *vjetor* lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm

Për periudhën prej 01.01.2017-31.12.2017

Qëllimi i raportit vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm:

Raportimi tek Ministria e Financave – Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm lidhur me auditimet e kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm si dhe të dhënave të nevojshme për përpilimin e raportit unik (përmbledhës) tremujor/vjetor për sistemin e kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik.

Roli dhe qëllimi i auditimit të brendshëm:

“Auditimi i brendshëm” është veprimtari e pavarur me siguri objektive dhe këshillëdhënëse, për të shtuar vlerat dhe për të përmirësuar operacionet e organizatës. Ai ndihmon organizatën që të përmbush objektivat e saja, duke sjellë një qasje sistematike, të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efikasitetin e procesit të menaxhimit të rrezikut, kontrolleve dhe qeverisjes.

2. Të dhënat për Njësinë e Auditimit të Brendshëm dhe auditorët e brendshëm

2.1 Njësia e Auditimit të Brendshëm është themeluar sipas ligjit për auditim të brendshëm	(PO) JO
2.2 Nëse përgjigja është JO – thekso arsyt	
2.3 Auditimi i brendshëm është themeluar në njërën prej këtyre mënyrave:	
a) <u>Themelimi i njësisë së pavarur të auditimit të brendshëm e cila drejtpërdrejt i përgjigjet menaxhmentit të lartë të SSP-së;</u>	

b) Themelimi i një Njësie të Përbashkët të Auditimit të Brendshëm me propozim të disa SSP, me pëlqim paraprak të Ministrit të Financave; c) Marrëveshje pune me një njësi të veçantë të auditimit të brendshëm të themeluar nga Qeveria, për të ofruar shërbime të auditim.		
2.4 Njësia e auditimit të brendshëm në mënyrë organizative i përgjigjet drejtpërsëdrejti dhe ekskluzivisht menaxhmentit të lartë të subjekti të sektorit publik		(PO) JO
2.5 Nëse përgjigjja është JO – thekso kujt i përgjigjet dhe arsyet:		
2.6 A është plotësuar Njësia e Auditimit të Brendshëm sipas kërkesave ligjore		
Kërkesat minimale ligjore për numrin e auditorëve	Numri aktual i auditorëve	Burimet e nevojshme për auditim
2	1	2
2.7 Nëse përgjigjja është se njësia e auditimit nuk është e plotësuar me numrin minimal të auditorëve sipas kërkesave ligjore – atëherë duhet theksuar se cilat janë arsyet për mos plotësimin e njësive - Njësia e Auditimit të Brendshëm aktualisht ka Udhëheqësin e auditimit		
2.8 Drejtori i njësisë së auditimit të brendshëm dhe auditorët e brendshëm a i përmbushin kushtet e parapara me ligjin për auditim të brendshëm		(PO) JO
2.9 Nëse përgjigjja është JO thekso arsyet:		
2.10 Auditorët e brendshëm kryejnë vetëm punët e auditimit të brendshëm:		(PO) JO
2.11 Nëse përgjigjja është JO – atëherë duhet theksuar cilat punë i kryen dhe cilat janë arsyet:		
2.12 Auditorët e brendshëm kanë qasje të plotë, të lirë dhe të pakufizuar te:		
a) Të gjithë dokumentacioni:	(PO)	JO
b) Të dhënat dhe informatat tek të gjithë bartësit e të dhënave:	PO	JO
c) Menaxhmenti i lartë i subjektit të sektorit publik:	PO	JO
d) Personeli (udhëheqësi dhe të punësuarit):	PO	JO
e) Pasuria materiale:	PO	JO
2.13 Nëse përgjigjja është JO – duhet theksuar arsyet:		
Buxheti i organizatës buxhetore		
2.14 Paga dhe rogat	8.027.579.00 €	
2.15 Mallra dhe shërbime	1.075.337.00 €	
2.15.1 Shpenzimet komunale	262.000.00 €	
2.16 Subvencione dhe transfere	280.999.00 €	
2.17 Kapitale	4.137.617.00 €	
buxheti	Gjithsej	13.783.532.00 €
2.18 Njësia e auditim të brendshëm ka buxhetin e ndarë		PO (JO)
2.19 Nëse përgjigjja është PO - sa është buxheti i saj		
2.20 Nëse përgjigjja është JO - në cilin departament është i vendosur buxheti i Njësisë së auditimit të brendshëm - Zyra e Kryetarit		
3. Zbatimi standardeve dhe metodologjisë së punës së Auditimit të Brendshëm		
Zbatimi i Doracakut të auditimit të brendshëm		
3.1 Auditorët e brendshëm kanë një ekzemplar të Doracakut të auditimit të brendshëm		(PO) JO

3.2 Auditorët e brendshëm, përpos Doracakut të auditimit të brendshëm kanë edhe shtesën e vet të doracakut për auditim të brendshëm	PO	(JO)
3.3 Nëse përgjigja është PO – a është kërkuar pëlqimi për shtesën në doracakun e NjQHAB	PO	JO
3.4 Nëse përgjigja është JO – të theksohen arsyet		
3.5 Auditorët e brendshëm në kryerjen e auditimeve të veçanta/me kërkesë u përmbahen në tërësi fazave të proceseve të auditimit të përcaktuara me Doracakun e auditimit të brendshëm	(PO)	JO
3.6 Nëse përgjigja është JO – theksoni arsyet:		
Statuti i auditimit të brendshëm		
3.7 Njësia e auditimit të brendshëm ka statutin e auditimit të brendshëm	(PO)	JO
3.8 Nëse përgjigja është JO – theksoni arsyet:		
3.9 Statuti i auditimit të brendshëm është i nënshkruar nga menaxhmenti i lartë i organizatës buxhetore dhe drejtorit të njësisë së AB	(PO)	JO
3.10 Nëse përgjigja është po – shkruaj datën e aprovimit të statutit 27.01.2016		
Zbatimi i kodit të etikës profesionale të AB		
3.11 Auditorët e brendshëm i përmbahen parimeve dhe rregullave të përcaktuara me Kodin e etikës profesionale:	(PO)	JO
3.12 Nëse përgjigja është JO – theksoni arsyet dhe rastet e mos përmbajtjes:		
Kryerja e auditimit të brendshëm		
3.13 Plani strategjik i auditimit të brendshëm është përpiluar në bazë të vlerësimit të rrezikut:	(PO)	JO
3.14 Nëse përgjigja është JO – theksoni arsyet:		
3.15 Planin strategjik të auditimit të brendshëm e ka aprovuar menaxhmenti i lartë i organizatës buxhetore dhe komiteti i auditimit	(PO)	JO
3.16 Nëse përgjigja është JO – theksoni arsyet:		
3.17 Plani vjetor i AB është hartuar në bazë të Planit strategjik të AB:	(PO)	JO
3.18 Nëse përgjigja është JO – theksoni arsyet:		
3.19 Planin vjetor të AB të brendshëm e ka miratuar menaxhmenti i lartë i organizatës buxhetore dhe komiteti i auditimit	(PO)	JO
3.20 Nëse përgjigja është JO – theksoni arsyet:		
3.21 Organizata juaj buxhetore ka themeluar Komitetin e Auditimit	(PO)	JO
3.22 Nëse përgjigja është JO – theksoni arsyet:		
Përgatitja dhe zbatimi i planit vjetor të auditimit të brendshëm		
3.23 Gjithsej numri i auditimeve të planifikuara me plan vjetor sipas periudhave tremujore dhe realizimi i tij (vetëm për të cilat janë përpiluar raportet vjetore)		

Periudha raportuese	Numri i auditimeve të planifikuara	Ditët e planifikuar për kryerjen e auditimit	Numri i auditorëve të planifikuar për angazhim	Numri i auditimeve të kryera	Koha e shpenzuar për kryerjen e auditimit	Numri i auditorëve të angazhuar për auditim
TM1	1	10	1	1	23	1
TM2	3	55	1	2	65	1
TM3	2	50	1	4	56	1
TM4	2	60	1	3	59	1
Vjetore	8	175	1	10	203	1
3.24 Arsyet për mos kryerjen e auditimeve sipas numrit të planifikuar të auditimit të brendshëm – theksoni arsyet:						
3.25 Auditimet e planifikuara dhe realizuar me kërkesë të menaxhmentit të lartë të subjektit të sektorit publik						
Numri i auditimeve të planifikuara me kërkesë të menaxhmentit	Ditët e planifikuar për kryerjen e auditimit	Numri i auditorëve të planifikuar për angazhim	Numri i auditimeve të realizuara	Koha e shpenzuar për kryerjen e auditimit me kërkesë	Numri i auditorëve të angazhuar për auditim me kërkesë	
3.26 Menaxhmentit të lartë të organizatës buxhetore i dërgohen raportet finale të auditimit menjëherë pas kryerjes së AB						(PO) JO
3.27 Nëse përgjigjja është JO – Theksoni si i dërgohen menaxhmentit të lartë raportet finale të auditimit:						
a) Menaxhmentit të lartë i dërgohen të gjitha raportet e auditimit në fund të periudhës raportuese; b) Menaxhmentit të lartë i dërgohen raportet e auditimit kohë pas kohe; c) Në mënyrë tjetër (theksoni si)						
3.28 Menaxhmenti i lartë i organizatës buxhetore përpilon dhe vendos për planin e veprimit i cili përfshinë rekomandimet e pranuar dhe veprimet të cilat duhet të ndërmerren në pajtim me ligjin për auditim të brendshëm						PO JO
3.29 Nëse përgjigjja është JO – theksoni arsyet: <i>Plani i veprimit përpilohet nga drejtori i drejtorisë në të cilën është kryer Auditimit , ku janë konstatuar të gjeturat dhe janë dhënë rekomandimet , kështu që personi përgjegjës për Implementimin e rekomandimeve është Drejtori i programit të caktuar buxhetor . Për të gjeturat të cilat kanë ndikim të madh për Organizatën të gjeturat diskutohen edhe me Kryesuesin e OB , në mënyrë që të ushtroj ndikimin e tij lidhur me implementimin e rekomandimeve.Me Menaxhmentin e lartë të OB i mbajmë takimet përmbyllse me zyrtaret të entiteteve të audituar.</i>						
3.30 Për rekomandimet e dhëna në raportet e auditimit njësia për auditimit të brendshëm ka bazën e organizuar të dhënave për zbatimin e rekomandimeve:						(PO) JO
3.31 Nëse përgjigjja është JO – theksoni arsyet:						
3.32 Rekomandimet e dhëna përcjellën sipas planit të veprimit, ashtu sikur është përcaktuar me doracak të auditimit të brendshëm						(PO) JO
3.33 Nëse përgjigjja është JO – thekso arsyet:						
Numri i rekomandimeve në raportet e auditimit/planet e veprimit dhe numri i rekomandimeve të zbatuara në periudhën raportuese:						
3.34 Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit:						94
3.35 Numri i rekomandimeve të zbatuara:						63

3.36 Numri i rekomandimeve në proces:	23
3.37 Numri i rekomandimeve të pazbatuara:	8
3.38 Nëse ekzistojnë rekomandime të pazbatuara thekso arsyet e moszbatimit: - Periudhën raportuese janë dhënë gjithsej 94 për te cilat ne planin e veprimit janë dhen afatet kohore se do te implementohen ne periudhën e caktuara - Te zbatuar-63 - Në proces- 23 - Pazbatuara :8 - Për zbatimet e rekomandimeve të pa zbatuar pritjet janë që të implementohen në dy periudhat e vitit në vijim	
II Pjesa e veçantë	
1. Pasqyra e auditimeve të kryera dhe ndryshimi nga plani vjetor i auditimit, duke theksuar arsyet e ndryshimit ose moskryerjes së auditimeve të planifikuara	
Thekso të gjitha auditimet e kryera në periudhën raportuese me të gjeturat e rëndësishme dhe rekomandimet, dhe drejtimi i shkurt për secilin auditim.	
1.1 Emërtimi i auditimit: Ecurit dhe progresi lidhur me jetësimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e finalizuar të auditimeve gjatë vitit 2016.	
Të gjeturat (përshkruaj të gjeturat) Nga gjithsej (83) rekomandime të dhëna gjatë vitit 2016 nga NJAB ne kemi vlerësuar se : Të adresuara tërësisht (34) rekomandime; Pjesërisht dhe ne proces (38) rekomandime dhe Të pa adresuara (11) rekomandime	
-Kontrolli i operimeve të brendshëm ka treguar dobësi në hartimin dhe zbatimin e planeve të veprimeve. -Kontrolli i brendshëm nuk ka qenë plotësisht adekuat dhe i mjaftueshëm në adresimin e plotë të rekomandimeve si rezultat janë të pa adresuar (njëmbëdhjetë) 11 rekomandime , 30 (tridhjetë) rekomandime janë adresuar pjesërisht dhe 8 (tetë) rekomandime janë ne procese të zbatimit bazuar sipas afateve të përcaktuara në planet e veprimeve ne disa sisteme dhe nënsisteme të audituara	
Rekomandimet (përshkruaj rekomandimet, të cilat kanë të bëjnë me të gjeturat e përshkruara)	
3.3.1 Rekomandim: Rekomandojmë menaxhmentin e lartë që të merr veprime të nevojshme lidhur me implementimin e rekomandimeve të pa adresuara dhe ato pjesërisht të adresuar, duke ndërmarr veprime konkrete në mbikëqyrjen e procesit dhe të kërkoj llogaridhënie nga bartësit të cilët janë ngarkuar për adresimin e rekomandimeve .	
3.3.2 Menaxhmentet ne vijim pas marrjes se raporteve finale në afat më së largu prej 10 ditëve të projektojnë dhe dizajnojnë plane të veprimeve konkrete në të cilën përcaktohen bartësit , afatet ,periudhat për implementimin e rekomandimeve,dhe për mënyrën ,përformancën e arritur dhe afatin e implementimeve të japin llogaridhënie Menaxhmentit të lartë të komunës,Komitetit të auditimit dhe NJAB-it.	

Përmbajtja e shkurt drejtuese:

Vendosja e kontrollave adekuate ne hartimin dhe rishikimin e planeve të veprimit i projektuar ne adresimin e rekomandimeve të dhëna gjate vitit 2016.

1.2 Emertimi i auditimit:

Rregullsitë lidhur me menaxhimin e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën kontabël 01.01.2017 deri më 31.05.2017.

Entiteti i audituar:

Gjimnazi “Jeta e re “ n’ Suharekë

Të gjeturat

1. Kemi konstatuar dobësi në mos përgatitjen e projekt buxhetit të shkollës, mos miratim nga ana këshillit të shkollës dhe mos dërgimi në DKA në mënyrë të dokumentuar për shqyrtim dhe miratim (shi çështja 3.1.1)
2. Dobësi në sistemin i regjistrimit të transaksioneve dhe mbajtja e librave me regjistrime të dyfishta. (shih çështjen 3.1.2)
3. Planifikimi jo i mirë i projekt buxhetit fillestar për nën kategoritë e shpenzimeve për mallra dhe shërbime, dobësi në realizimin e buxhetit për mallra dhe shërbime sipas nën kategorive të shpenzimeve. (Shih çështjen e ngritur 3.1.3).
4. Moszbatimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut – (Shi çështjen 3.1.4)
5. Pagesat për shpenzimet të komunalëve pa raporte dhe marrëveshje dialoguese për çmime dhe cilësinë e shërbimeve (çështja 3.1.5)
6. Dobësi të kontrollit në sistemin i pagesave dhe hyrja në obligime pa i siguruar fonde të mjaftueshme, pagesat pas afatit (çështja 3.1.6)
7. Dobësi në mos evitimin e ndarjes se pagesave që janë kryesisht të natyrës së njëjtë apo të ngjashme (çështja 3.1.7).
8. Dobësi e kontrollit në sistemin e raportimeve për obligimet e papaguara në baza mujore sipas afatit të paraparë dhe raportimet në baza mujore për administrimin e buxhetit të shkollave. (Çështja 3.1.8)
9. Dobësi e kontrollit në regjistrimin e stokut të bllok dëftesave për arkëtim me gjendjen që përfundon më 31.12.2016 (çështja 3.1.10).
10. Dobësi në planifikim dhe grumbullim të të hyrave vetjake, trajtimin e të arkëtueshmëve dhe vonesa në depozitimin e të hyrave vetjake në llogarinë zyrtare (çështja 3.1.11)
11. Dobësi e kontrollit në mos shpërndarje të porositve sipas kërkesave dhe regjistrimi i pasurive jo financiare dhe jo kapitale në sistemin E pasuria (shi çështja 3.1.13)

Rekomandimet**3.3.1 Rekomandim**

-Menaxhmenti i shkollës pas marrjes së njoftimit mbi ndarjet buxhetore duhet ta përgatit projekt buxhetin e shkollës sipas kërkesave mbi ndarjet buxhetore sipas formulës së për- caktuar nga DKA-ja dhe qarkoreve buxhetore nr 1 dhe 2, të diskutohet dhe analizohet në mënyrë të detajuar dhe të aprovohet nga këshilli i shkollës dhe një kopje të konfirmuar nga këshilli i shkollës dhe Drejtori të dërgohet në mënyrë të dokumentuar për procedura të mëtejme në DKA për vlerësim, analizim dhe miratim nga Drejtori si dhe vlerësim dhe miratim nga ana e Kryetarit të komunës.

3.3.2 Rekomandim

Menaxhmenti në vijim duhet të koordinoj veprimet me departamentin e financave të DKA-së për vendosjen e kontrollave efikase dhe të projektuar mirë dhe profesionalisht në identifikimin dhe regjistrimin e të gjitha transaksioneve dhe llogarive financiare me kohë dhe në mënyrë përditësore të shkollave në librat me regjistrime të dyfishta sipas Standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik.

3.3.3 Rekomandim

- Menaxhmenti duhet të siguroj dhe vendos kontrolla dhe mekanizma adekuate të projektuara që planifikimi i buxhet te projektohet dhe përgatitet konform kërkesave që rrjedhin nga Qarkoret buxhetore me theks të çështje nën kategoritë e shpenzimeve për mallra dhe shërbime.
- Forcimin dhe vendosjen e kontrollave të brendshëm dhe të përgjithshme për një monitorim dhe menaxhim financiar të buxhetit në mënyrë ma efikase me theks të çështjes shpenzime nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.
- Te vendosin kontrolla adekuate të dizajnuara që ecurit buxhetore të përcillen me analiza përditësore dhe të kohëpaskohshme dhe në pajtim me situatën të merren veprime të menjëhershme.

3.3.4 Rekomandim

Menaxhmenti i entitetit të audituar me pranimin e përgjegjësive të deleguara nga DKA-ja dhe delegimin e autorizimeve të zyrtarë e autorizuar për monitorimin e sistemeve qe operojnë në kuadër të entitetit të audituar i projektuar për identifikimin , vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve në vijim duhet të sigurojnë zbatimin e kërkesave për këtë sistem dhe të sigurojnë forcimin e kontrollit që rreziqet të jenë nën kontroll dhe për performanën e arritur në formë të shkruar në baza mujore të raportojë te Menaxhmentit të DKA-së(në tekstin e mëtejme”llogaridhënia”).

3.3.5 Rekomandim

- Menaxhmenti ne vijim duhet të siguroj dhe të krijoj politika të qarta dhe mekanizma efikas që para çdo pagese të shpenzimeve komunale të sigurohet raporti i saktësisë dhe cilësisë së krijimit te shpenzimeve tutje të përcaktohet një limit real për shpenzimet e ujit dhe rrymës.
- Për shpenzimet e ujit të sigurohet marrëveshja në të cilën do të përcaktohen çmimet dhe ofrimi i cilësisë së kryerjes së shërbimeve.

3.3.6 Rekomandim

- Menaxhmenti në vijim duhet të siguroj dhe të forcoj kontrollin dhe të vendos politika dhe mekanizma efikase që mos filloj asnjë procedurë për iniciimin dhe krijimin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime:
- Pa kërkesë fillestare për furnizim dhe e miratuara nga mbajtësi i buxhetit
 - Para porosisë të bëhet zotimi i mjeteve,zyra e prokurimit nxjerrë urdhër blerjen dhe më pastaj bëhet porosia e mallit apo shërbimeve.
 - Kompletimi i procedurave me ofertë financiare dhe harmonizimi i çmimeve me çmimet e kontraktuara
 - Menaxhmenti ne vijim duhet të forcoj kontrollin menjëherë që asnjë porosi,faturë ,fletë dërgesë mos të pranohet dhe asnjë pagesë mos procedohet nëse paraprakisht kërkesat e cekura si më lartë nuk janë siguruar.

3.3.7 Rekomandim.

- Menaxhmenti në vijim duhet të forcoj kontrollin në identifikimin e rrezikut dhe vendosjen e kontrollave efikase dhe efektive në parandalimin dhe evitimin e ndarjes së kërkesave të pagesave të shpenzimeve që kanë qëllimin dhe janë të natyrës së njëjtë të shpenzimeve.
- Menaxhmenti në vijim më qëllim të evitimit të ndarjes së kërkesave të siguroj paraprakisht një vlerësim të përgatitjes së kontratave të parashikuar vlere e të cilave pritjet të jetë në atë nivel që kërkohet të udhëhiqen procedurat transparente të prokurimit.

3.3.8 Rekomandim

- Menaxhmenti ne vijim duhet po ashtu të forcoj kontrollin i dizajnuar që sistemi aktual të rishikohet dhe të forcohet për të siguruar në vijim raportime efikase dhe efektive për shkollë në përshtatshmëri me rregullat mbi bazën e nenit 5 dhe 6 të Rregullës financiare nr 02/2013 MF për raportimin e obligimeve të pa paguar të organizatave buxhetore.

3.1.9 Rekomandim

Menxhmetit i mbetet në vijim pas përfundimit të vitit përkatësisht me gjendjen 31.12.2017 të formoj dhe autorizoj një komision për identifikimin dhe regjistrimin e stokut të bllok dëftesave në formë të shkruar dhe te dokumentuar mirë. Kopje të regjistrimit të stokut të arkivohet dhe të u dërgohet zyrtareve të tjerë relevant të angazhuar në nënsistemin e arkëtimeve të bashkë pagesave për të hyrat vetjake. Bllok dëftesat duhet te pranohen në mënyrë të dokumentuar dhe të autorizuar nga Menaxhmenti.

3.3.10 Rekomandim

-Menaxhmenti ne vijim duhet te vendos kontrolla adekuate dhe të hyrat e realizuar nga qiraja të paguhen dhe të depozitohen në llogarinë bankare zyrtare të komunës.

-Menaxhmenti duhet të siguroj në vijim që të gjitha mjetet e grumbulluara që klasifikohen si të hyra vetjake të dorëzohen-depozitohen menjëherë nga ana e zyrtarit financiar në llogarinë bankare zyrtare të komunës në përshtatshmëri me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi i aplikuar nga viti 2008(neni 58).

-Të vendos politika dhe procedura adekuate në forcimin e kontrollit në ndërmarrjen e veprimeve ndaj qiramarrësve për mos respektim të kushteve që rrjedhin nga kontrata në fokus që pagesat të kryhen sipas afatit të përcaktuar në kontratat e nënshkruar dhe në arkëtimin e të arkëtueshmeve dhe raportimin e tyre.

3.3.11 Rekomandim

Menaxhmenti në vijim duhet të siguroj që të gjitha pasurit jo financiare dhe jo kapitale të pranohen sipas kërkesave të porosive dhe informacioni i pranimit të bashkëngjitet raportit të pranimit të porosive në mënyrë që zyrtari i pasurisë të identifikoj dhe regjistroj si informacion i besueshme në sistemin e pasurisë.

Përmbajtja e shkurt drejtuese:

Për të rishikuar se e veprimet në sistem janë në përshtatshmëri me ligjet dhe legjislacionin në fuqi, rishikimi se planifikimi i buxhetit është përgaditë karshi përmbushjes së objektivave të përcaktuar dhe në përshtatshmëri me qarkoret buxhetore 1 dhe 2, dhe me linjat e autorizuar buxhetore. rishikimi se sistemi i kontrollit të brendshëm në administrimin e buxhetit të shkollës është efikas,efektiv dhe i mjaftueshëm,rishikimi se ruajtja e mirëmbajtja dhe mbikëqyrja e pasurive fikse është nën kontroll të mjaftueshëm efikas dhe efektiv,dizajnimi i kontrollave të brendshme financiare janë në përshtatshmëri me rregullat e MFK dhe KBFP

1.3 Tema e auditimit :

Rregullsitë lidhur me menaxhimin e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën kontabël 01.01.2017 deri më 31.05.2017

Entiteti i audituar:

SHFMU”Destan Bajraktari”në Suharekë

Te gjeturat

-Dobësi në mos përgatitjen e projekt buxhetit të shkollës,mos miratim nga ana këshillit të shkollës dhe mos dërgimi në DKA në mënyrë të dokumentuar për shqyrtim dhe miratim (çështja 3.1).

-Dobësi në sistemin i regjistrimit të transaksioneve dhe mbajtja e librave me regjistrime të dyfishta(3.1.2)

- Planifikimi jo i mirë i projekt buxhetit fillestar për nën kategoritë e shpenzimeve për mallra dhe shërbime , dobësi në realizimin e buxhetit për mallra dhe shërbime sipas nën kategorive të shpenzimeve (3.1.3).

-Moszbatimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut (3.1.4).

-Dobësi të kontrollit në sistemin i pagesave ,hyrja në obligime pa i siguruar fonde të mjaftueshme , pagesat pas afatit dhe mos dokumentimi i pranimit të porosive në mënyrë individuale(3.1.5)

-Dobësi në mos evitimin e ndarjes se pagesave që janë kryesisht të natyrës së njëjtë apo të ngjashme(3.1.6).

- Dobësi të kontrollit të sistemit të raportimeve për obligimet e papaguara në baza mujore sipas afatit të paraparë dhe raportimet në baza mujore për administrimin e buxhetit të shkollave.(3.1.7)

-Dobësi në planifikim dhe grumbullim të të hyrave vetjake trajtimin e të arkëtueshmëve ,mos pagesa e shpenzimit për ujë dhe vonesa në pagesë të qirasë dhe depozitim të të hyrave vetjake në llogarinë zyrtare-(3.1.8)

- Dobësi e kontrollit në mos shpërndarje të porosive sipas kërkesa dhe regjistrimi i pasurive jo financiare dhe jo kapitale në sistemin E pasurisë (3.1.9)

Rekomandimet

3.3.1 Rekomandim

-Menaxhmenti i shkollës pas marrjes së njoftimit mbi ndarjet buxhetore duhet ta përgatit projekt buxhetin e shkollës sipas kërkesave mbi ndarjet buxhetore sipas formulës së përcaktuar nga DKA-ja dhe qarkoreve buxhetore nr 1 dhe 2 ,të diskutohet dhe analizohet në mënyrë të detajuar dhe të aprovohet nga këshilli i shkollës dhe një kopje të konfirmuar nga këshilli i shkollës dhe Drejtori të dërgohet në mënyrë të dokumentuar për procedura të mëtejme në DKA për vlerësim,analizim dhe miratim nga Drejtori si dhe vlerësim dhe miratim nga ana e Kryetarit të komunës.

3.3.2 Rekomandim

Menaxhmenti në vijim duhet të koordinoj veprimet me departamentin e financave të DKA-së për vendosjen e kontrollave efikase dhe të projektuar mirë dhe profesionalisht në identifikimin dhe regjistrimin e të gjitha transaksioneve dhe llogarive financiare me kohë dhe në mënyrë përditësore të shkollave në librat me regjistrime të dyfishta sipas Standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik. Raportet duhet të dorëzohen me kohë në baza mujore dhe periodike dhe të në mënyrë të dokumentuar dhe të konfirmuar në mënyrë reciproke në DKA.

3.3.3 Rekomandim

- Manaxhmenti duhet të siguroj dhe vendos kontrolla dhe mekanizma adekuate të projektuara që planifikimi i buxhet të projektohet dhe përgatitet konform kërkesave që rrjedhin nga Qarkoret buxhetore me theks të çështje nën kategoritë e shpenzimeve për mallra dhe shërbime.

-Forcimin dhe vendosjen e kontrollave të brendshëm dhe të përgjithshme për një monitorim dhe menaxhim financiar të buxhetit në mënyrë ma efikase me theks të çështjes shpenzime nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve dhe shpenzimeve komunale.

-Te vendosin kontrolla adekuate të dizajnuara që ecurit buxhetore të përcillen me analiza përditësore dhe të kohëpaskohshme dhe në pajtim me situatën të merren veprime të menjëhershme,

3.3.4 Rekomandim

Menaxhmenti i entitetit të audituar me pranimin e përgjegjësive të deleguara nga DKA-ja dhe delegimin e autorizimeve të zyrtarëve të autorizuar për monitorimin e sistemeve që operojnë në kuadër të entitetit të audituar i projektuar për identifikimin , vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve në vijim duhet të sigurojnë zbatimin e kërkesave për këtë sistem dhe të sigurojnë forcimin e kontrollit që rreziqet të jenë nën kontroll dhe për performancën e arritur në formë të shkruar në baza mujore të raportojë te Menaxhmentit të DKA-së(në tekstin e mëtejme”llogaridhënia”).

3.3.5 Rekomandim

Menaxhmenti në vijim duhet të siguroj dhe të forcoj kontrollin dhe të vendos politika dhe mekanizma efikase që të mos filloj asnjë procedurë për iniciimin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime:

-Pa kërkesë fillestare për furnizim dhe përshkrim analitik të artikujve dhe e miratuara nga mbajtësi i buxhetit

-Para porosisë të bëhet zotimi i mjeteve,zyra e prokurimit nxjerrë urdhër blerjen dhe më pastaj bëhet porosia e mallit apo shërbimeve.

-Menaxhmenti në vijim duhet të forcoj kontrollin menjëherë që asnjë porosi,faturë ,fletë dërgesë mos të pranohet dhe asnjë pagesë mos procedohet nëse paraprakisht nuk janë plotësuar kërkesat e cekura si më lartë.

3.3.6 Rekomandim.

-Menaxhmenti në vijim duhet të forcoj kontrollin në identifikimin e rrezikut dhe vendosjen e kontrollave efikase dhe efektive në parandalimin dhe evitimin e ndarjes së kërkesave të pagesave të shpenzimeve që kanë qëllimin dhe janë të natyrës së njëjtë të shpenzimeve.

-Menaxhmenti në vijim më qëllim të evitimit të ndarjes së kërkesave të siguroj paraprakisht një vlerësim të përgatitjes së kontratave të parashikuar vlera e të cilave pritët të jetë në atë nivel që kërkohet të udhëhiqen procedurat transparente të prokurimit

3.3.7 Rekomandim

-Menaxhmenti ne vijim duhet po ashtu të forcoj kontrollin i dizajnuar që sistemi aktual të rishikohet dhe të forcohet për të siguruar në vijim raportime efikase dhe efektive për shkollë në përshtatshmëri me rregullat mbi bazën e nenit 5 dhe 6 të Rregullës financiare nr 02/2013 MF për raportimin e obligimeve të pa paguar të organizatave buxhetore.

3.3.8 Rekomandim

-Menaxhmenti ne vijim duhet te vendos kontrolla adekuate dhe të hyrat e realizuar nga qiraja të paguhen dhe të depozitohen në llogarinë bankare zyrtare të komunës.

-Menaxhmenti duhet të siguroj në vijim që të gjitha mjetet e grumbulluara që klasifikohen si të hyra vetjake të dorëzohen-depozitohen menjëherë nga ana e zyrtarit financiar në llogarinë bankare zyrtare të komunës në përshtatshmëri me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi i aplikuar nga viti 2008(neni 58).

-Të vendos politika dhe procedura adekuate në forcimin e kontrollit në ndërmarrjen e veprimeve ndaj qiramarrësve për mos respektim të kushteve që rrjedhin nga kontrata në fokus që pagesat për qira dhe pagesat për ujë të kryhen sipas afatit të përcaktuar në kontratat e nënshkruar dhe në arkëtimin e të arkëtueshmeve dhe raportimin e tyre.

3.3.9 Rekomandim

Menaxhmenti në vijim duhet të siguroj që të gjitha pasurit jo financiare dhe jo kapitale të pranohen sipas kërkesave të porosive dhe informacioni i pranimit të bashkëngjitet raportit të pranimit të porosive në mënyrë që zyrtari i pasurisë të identifikoj dhe regjistroj si informacion i besueshme në sistemin e-pasuria.

Përmbajtja e shkurt drejtuese:

Për të rishikuar se e veprimet në sistem janë në përshtatshmëri me ligjet dhe legjislacionin në fuqi, rishikimi se planifikimi i buxhetit është përgaditë karshi përmbushjes së objektivave të përcaktuar dhe në përshtatshmëri me qarkoret buxhetore 1 dhe 2, dhe me linjat e autorizuar buxhetore. rishikimi se sistemi i kontrollit të brendshëm në administrimin e buxhetit të shkollës është efikas,efektiv dhe i mjaftueshëm,rishikimi se ruajtja e mirëmbajtja dhe mbikëqyrja e pasurive fikse është nën kontroll të mjaftueshëm efikas dhe efektiv,dizajnimi i kontrollave te brendshme financiare janë në përshtatshmëri me rregullat e MFK

1.4 Emërtimi i auditimit:

Rregullsitë lidhur me menaxhimin e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën kontabël 01.01.2017 deri më 30.06.2017.

Entiteti i audituar:

SHMT"Skender Luarasi " në Suharekë

Te gjeturat: 1. Dobësi në mos përgatitjen e projekt buxhetit të shkollës,mos miratim nga ana këshillit të shkollës dhe mos dërgimi në DKA në mënyrë të dokumentuar për shqyrtim dhe miratim(Çështja 3.1)

2. Dobësi në sistemin e regjistrimit të transaksioneve dhe mbajtja e librave me regjistrime të dyfishta(çështja 3.1.2)

3. Planifikimi jo i mirë i projekt buxhetit fillestar për nën kategoritë e shpenzimeve për mallra dhe shërbime , dobësi në realizimin e buxhetit për mallra dhe shërbime sipas nën kategorive të shpenzimeve (Çështja 3.1.3)

4. Moszbatimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut –(Çështja 3.1.4)

5. Pagesat për shpenzimet e komunalëve pa raporte dhe marrëveshje dialoguese dhe procedura të prokurimit për çmime dhe cilësinë e shërbimeve-(Çështja 3.1.5)

6. Dobësi të kontrollit në sistemin i pagesave dhe hyrja në obligime pa i siguruar fonde të mjaftueshme dhe pagesat pas afatit –(çështja 3.1.6)

7. Dobësi në mos evitimin e ndarjes së pagesave që janë kryesisht të natyrës së njëjtë apo të ngjashme-(çështja 3.1.7)

8. Dobësi e kontrollit në sistemin e raportimeve për obligimet e papaguara në baza mujore sipas afatit të

paraparë –(Çështja 3.1.8)

9. Dobësi e kontrollit në mos shpërndarje të porosive sipas kërkesa dhe regjistrimi i pasurive jo financiare dhe jo kapitale në sistemin E pasuria-(Shih çështjen e ngritur 3.1.9)

Rekomandimet

3.3.1 Rekomandim

-Menaxhmenti i shkollës pas marrjes së njoftimit mbi ndarjet buxhetore duhet ta përgatit projekt buxhetin e shkollës sipas kërkesave mbi ndarjet buxhetore sipas formulës së për- caktuar nga DKA-ja dhe qarkoreve buxhetore nr 1 dhe 2 ,të diskutohet dhe analizohet në mënyrë të detajuar dhe të aprovohet nga këshilli i shkollës dhe një kopje të konfirmuar nga këshilli i shkollës dhe Drejtori të dërgohet në mënyrë të dokumentuar për procedura të mëtejme në DKA për vlerësim,analizim dhe miratim nga Drejtori si dhe vlerësim dhe miratim nga ana e Kryetarit të komunës.

3.3.2 Rekomandim

Menaxhmenti në vijim duhet të koordinoj veprimet me departamentin e financave të DKA-së për vendosjen e kontrollave efikase dhe të projektuar mirë dhe profesionalisht në identifikimin dhe regjistrimin e të gjitha transaksioneve dhe llogarive financiare me kohë dhe në mënyrë përditësore të shkollave në librat me regjistrime të dyfishta sipas Standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik.

3.3.3 Rekomandim

- Manaxhmenti duhet të siguroj dhe vendos kontrolla dhe mekanizma adekuate të projektuara që planifikimi i buxhet të projektohet dhe përgatitet konform kërkesave që rrjedhin nga Qarkoret buxhetore me theks të çështje nën kategoritë e shpenzimeve për mallra dhe shërbime.

-Forcimin dhe vendosjen e kontrollave të brendshëm dhe të përgjithshme për një monitorim dhe menaxhim financiar të buxhetit në mënyrë ma efikase me theks të çështjes shpenzime nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

-Te vendosin kontrolla adekuate të dizajnuara që ecurit buxhetore të përcillen me analiza përditësore dhe të kohëpaskohshme dhe në pajtim me situatën të merren veprime të menjëhershme,

3.3.4 Rekomandim

Menaxhmenti i entitetit të audituar me pranimin e përgjegjësive të deleguara nga DKA-ja dhe delegimin e autorizimeve të zyrtaret e autorizuar për monitorimin e sistemeve që operojnë në kuadër të entitetit të audituar i projektuar për identifikimin , vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve në vijim duhet të sigurojnë zbatimin e kërkesave për këtë sistem dhe të sigurojnë forcimin e kontrollit që rreziqet të jenë nën kontroll dhe për performancën e arritur në formë të shkruar në baza mujore të raportojë te Menaxhmentit të DKA-së(në tekstin e mëtejme”llogaridhënia”).

3.3.5 Rekomandim

Menaxhmenti në vijim duhet të siguroj dhe të krijoj politika të qarta dhe mekanizma efikas që para çdo pagese të shpenzimeve komunale të sigurohet raporti i saktësisë dhe cilësisë së krijimit te shpenzimeve tutje të përcaktohet një limit real për shpenzimet e ujit dhe mbeturinave.

-Për shpenzimet e ujit dhe mbeturinave të sigurohet marrëveshja përkatësisht procedura të prokurimit për mbeturina në të cilën do të përcaktohen çmimet dhe ofrimi i cilësisë së kryerjes së shërbimeve

3.3.6 Rekomandim

Menaxhmenti në vijim duhet të siguroj dhe të forcoj kontrollin dhe të vendos politika dhe mekanizma efikase që të mos filloj asnjë procedurë për iniciimin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime:

-Pa kërkesë fillestare për furnizim dhe e miratuara nga mbajtësi i buxhetit

-Para porosisë të bëhet zotimi i mjeteve,zyra e prokurimit nxjerrë urdhër blerjen dhe më pastaj bëhet porosia e mallit apo shërbimeve.

-Kompletimi i procedurave me ofertë financiare dhe harmonizimi i çmimeve me çmimet e kontraktuara

-Menaxhmenti ne vijim duhet të forcoj kontrollin menjëherë që asnjë porosi,faturë ,fletë dërgesë mos të pranohet dhe asnjë pagesë mos procedohet nëse paraprakisht, kërkesat e cekura si më lartë nuk janë siguruar.

3.3.7 Rekomandim.

-Menaxhmenti në vijim duhet të forcoj kontrollin në identifikimin e rrezikut dhe vendosjen e kontrollave efikase dhe efektive në parandalimin dhe evitimin e ndarjes së kërkesave të pagesave të shpenzimeve që kanë qëllimin dhe janë të natyrës së njëjtë të shpenzimeve. Tutje një vlerësim paraprak dhe i parashikuar vlera e të cilave pritet të jetë në atë nivel që kërkohet të udhëhiqen procedurat transparente të prokurimit.

3.3.8 Rekomandim

Menaxhmenti në vijim duhet të forcoj kontrollin në mos lejimin në hyrje në obligime në një vlerë e cila i tejkalon fondet e ndara.

-Menaxhmenti në vijim duhet po ashtu të forcoj kontrollin i dizajnuar që sistemi aktual të rishikohet dhe të forcohet për të siguruar në vijim raportime efikase dhe efektive për shkollë në përshtatshmëri me rregullat mbi bazën e nenit 5 dhe 6 të Rregullës financiare nr 02/2013 MF dhe nenin 17 të Rregullores MF 01-2017 për obligimet e papaguar të krijuar deri me 31.12 të periudhës

3.3.9 Rekomandim

Menaxhmenti në vijim duhet të siguroj që të gjitha pasurit jo financiare dhe jo kapitale të pranohen sipas kërkesave të porosive dhe informacioni i pranimit të i bashkëngjitet raportit të pranimit të porosive në mënyrë që zyrtari i pasurisë të identifikoj dhe regjistroj si informacion i besueshme në sistemin e- pasuria.

Përmbajtja e shkurt drejtuese:

Për të rishikuar se e veprimet në sistem janë në përshtatshmëri me ligjet dhe legjislacionin në fuqi, rishikimi se planifikimi i buxhetit është pergaditë karshi përmbushjes së objektivave të përcaktuar dhe në përshtatshmëri me qarkoret buxhetore 1 dhe 2, dhe me linjat e autorizuara buxhetore. rishikimi se sistemi i kontrollit të brendshëm në administrimin e buxhetit të shkollës është efikas,efektiv dhe i mjaftueshëm,rishikimi se ruajtja e mirëmbajtja dhe mbikëqyrja e pasurive fikse është nën kontroll të mjaftueshëm efikas dhe efektiv,dizajnimi i kontrollave te brendshme financiare janë në përshtatshmëri me rregullat e MFK dhe KBFP

1.5 Emërtimi i auditimit:

